



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 103 , Datë 24.06.2020**

**“MBI**

**TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR  
TË CILËT NUK KANË SHLYER PAGESAT RREGULLATORE”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 pika 1, gërma a, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; vendimit të bordit të ERE-s Nr. 51, datë 26.03.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave të marra pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.06.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e mundësisë (në kuadër të situatës të krijuar nga Covid-19), për shlyerjen e debisë brënda 30 diteve duke filluar nga data 24.06.2020,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 212, datë 18.12.2019, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019”, ka miratuar pagesat rregullatore për vitin 2019 për secilën shoqëri të licencuar nga ERE.
- Nga analizimi i ecures së arkëtimit të pagesave rregullatore për vitin 2020, konstatohet se shumë prej tyre janë debitorë të detyrimeve për vitin 2019, por edhe debitorë për pagesa të pashlyera të viteve të më parëshme.
- ERE ka njoftuar të licencuarit për vlerën dhe afatet e pagesës rregullatore në zbatim të nenit 17 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, me shkresë protkolluar me nr. 412./seri, datë 06.02.2020.
- Vendimi i ERE Nr. 212, datë 18.12.2019, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.188 datë 13.01.2020.
- Duke qenë se rezultojnë ende subjekte që nuk kanë kryer brenda afatit 30 ditor nga data e marrjes së njoftimit të ERE-s, pagesën rregullatore për vitin 2019 dhe disa prej tyre edhe pagesat rregullatore ndër vite, ERE-s i lind e drejta që për këta të licencuar të aplikojë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe rregulloren e miratuar për këtë qëllim.
- Qeveria Shqiptare me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, ka shpallur “Gjendjen e Fatkeqësisë Natyrore”, e cila ka përfunduar në datë 23.06.2020.

- Qeveria Shqipëtare ka marrë një sërë masash me qëllim lehtësimin e procedurave administrative të subjekteve tregëtare dhe personave fizikë gjatë periudhës së shtrirjes së efekteve kufizuese të gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore në Republikën e Shqipërisë.
- Enti Rregullator i Energjisë, për shkak të rrethanave të krijuara nga COVID-19, me vendimin Nr. 51, datë 26.03.2020, miratoi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në kuadër të masave të marra dhe nga Qeveria Shqipëtare pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë.
- Ndodhur në kushtet e një izolimi prej më shumë se dy muajsh për shkak të pandemisë Covid-19, pezullimit apo ngrirjes së aktiviteteve në Republikën e Shqipërisë, është e arsyeshme që afatet e parashikuara, nga legjislacioni në fuqi, si dhe njoftimi i ERE-s drejtuar të licencuarve, për shlyerjen e debisë së krijuar për shkak të mos kryerjes në afat të pagesave rregullatore nga të licencuarit, të shtyhet për një kohë të mjaftueshme për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve të pashlyera apo të prapambetura të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Shtyrjen deri në datën 31.07.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”i ndryshuar.
2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.07.2020.
3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar .
4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë të licencuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**